



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. 2148/prot.

Tiranë, më 22.05.2025

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1398, datë 20.08.2009.

SHOQËRISË “GENTARI” SH.P.K
Rr. “5 Maji”, Tregu i Lirë, Tiranë

Për dijeni: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “GENTARI” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1398, datë 20.08.2009, për mineralin krom, në Objektin “Qafë Vorrezë, Fregen, Ungrej”, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 1449 prot., datë 06.03.2025, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 2148 Prot., datë 10.03.2025, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1398, datë 20.08.2009, për mineralin krom, në Objektin “Qafë Vorrezë, Fregen, Ungrej”, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, pasi subjekti nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit për vitet 2023 dhe 2024.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 1398, datë 20.08.2009, për mineralin krom, në Objektin “Qafë Vorrezë, Fregen, Ungrej”, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1398, datë 20.08.2009, për mineralin krom, në Objektivin "Qafë Vorrezë, Fregen, Ungrej", Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

DHE

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME URDHËR PËR DELEGIM

ZËVENDËSMINISTRI

CENO KLOSI

